

DEKRET
Nr.13207, datë 1.9.2021

**PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË KUVENDIT TË PORSAZGJEDHUR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 65, pika 1, 67 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021, rezultati përfundimtar i të cilave është shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes vendimit nr.21, datë 13.7.2021, të Komisionit Rregullator, si dhe në kushtet kur Legjislaturës së IX-të të Kuvendit i përfundon mandati në datën 9.9.2021,

DEKRETOJ:

Neni 1

Ditën e premte, në datë 10 shtator 2021, ora 10:00, thirret për t'u mbajtur mbledhja e parë e Legjislaturës së X-të të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta